



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 160 Prot

Fier më, 12.05.2025

Lënda: Njoftim për Levizje Paralele .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit te burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit të vazhdueshem professional të personelit ”.

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton për Levizjen paralele ne pozicionin :

Pergjegjes I Sektorit te Administrimit te Formimit Profesional (Fier) 1 person

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a)Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b)Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c)Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d)Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e)Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f)Të demostroj aftësi te punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Të ketë diplomë të studimene universitare te nivelit “Master i shkencave ” (ose te

barazvlefshme) ne nje nga fushat qe lidhet me kualifikimet profesionale ne lidhje me ofrusit publik te AFP-se .

b)Të kete të paktën 3(vjet) përvojë pune ne profesion sipas percaktimeve ne shpalljen per pozicionin perkates

c)Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

a)letërmotivimin për pozicionin:

b)jetëshkrimin (CV-në)

c)kartën e indentitetit

d)diplomë/deftese e shkollës së mesme

e)libreza e punës

f)çdo dukumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jeteshkrim CV;

g)çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h)vërtetim i gjëndjes shëdetësore

i)vërtetimin e gjëndjes gjyqësore

j)vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi

k) të paktën nje rekomandim ose vleresim pune nga pudhënës të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara te tyre ; Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrusit të AFP-së brenda datës 23.05 2025

DREJTORE

Aleksander Lalaj

